



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 857/16 prot.,

Datë 08.05.2026

V E N D I M

Nr. 615/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|--------|
| Fiorent Zguro | Anëtar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Gjergj Mersini | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 08.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.559/2026, datë 28.04.2026, për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur me mjete elektronike*”, me Nr. REF-65194-10-15-2025, me objekt “*Rikonstruksion i objektit 3K (Çerdhe+kopesht), Lagjja "29 Nëntori", Fier*” me fond limit 44 449 209. 27 (*dyzet e katër milion e katërqind e dyzet e nente mijë e dyqind e nente pike njezet e shtate*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
- Ankimues:** OE “Shendelli” SHPK me NIPT K07924803N dhe me adresë Lagjja Kastrioti, rruga Andon Profka, 2 kullat Fier.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Fier me adresë Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 28.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.559/2026, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e OE ankimes “Shëndelli SHPK”, për procedurën e “Procedure e hapur me mjete elektronike”, me Nr. REF-65194-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion i objektit 3K (Çerdhe+kopesht), Lagjja "29 Nëntori", Fier” me fond limit 44 449 209. 27 (dizet e katër milion e katërqind e dizet e nente mije e dyqind e nente pike njezet e shtate) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.*
2. *Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Shëndelli” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Shëndelli” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën përcjellëse me nr. 11563/48 prot., datë 04.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 857/13 prot., datë 06.05.2026, autortiteti kontraktor Bashkia Fier, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 559/2026, datë 28.04.2026.

-Urdhërin e autoritetit kontraktor me nr.11563/44 prot., datë 30.04.2026;

-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 11563/47 prot., datë 04.05.2026, të nënshkruar nga anëtarët e KVO-së;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën përcjellëse me nr. 11563/48 prot., datë 04.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 857/13 prot., datë 06.05.2026, autortiteti kontraktor Bashkia Fier, ka dërguar me shërbim postar, informacion mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 559/2026, datë 28.04.2026.

-Urdhërin e autoritetit kontraktor me nr.11563/44 prot., datë 30.04.2026;

-Procesverbal rivlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 11563/47 prot., datë 04.05.2026, të nënshkruar nga anëtarët e KVO-së;

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik si edhe informacioni i dërguar me shkresën përcjellëse me nr. 11563/48 prot., datë 04.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 857/13 prot., datë 06.05.2026, nëpërmjet shërbimit postar, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.559/2026, datë 28.04.2026, duke rivlerësuar arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik “Shëndelli” Shpk. KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik, duke rivlerësuar këtë subjekt ofertues dhe pas rivlerësimit statusi nga “I skualifikuar” është ndryshuar në statusin “I kualifikuar”, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar, duke bashkëlidhur edhe procesverbalin e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 11563/47 prot., datë 04.05.2026, të nënshkruar nga anëtarët e KVO-së.

Gjithashtu, pas rivlerësimit, autoriteti kontraktor nga përlllogaritjet, nuk e ka cilësuar ofertën e OE “Shëndelli shpk” si ofertë anomalisht të ulët, në përputhje me parashikimet e ligjore, dhe në përfundim të analizës, për autoritetin kontraktor është krijuar bindja se është e rregullt me të gjithë elementët e saj, dhe e ka kualifikuar këtë OE, ku këto veprime janë pasqyruar nga autoriteti kontraktor me informacionin e dërguar si edhe në raportin e auditit të gjeneruar nga sistemi i prokurimit elektronik (SPE).

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedure e hapur me mjete elektronike*”, me Nr. REF-65194-10-15-2025, me objekt “*Rikonstruktion i objektit 3K (Çerdhe+kopesht), Lagjja "29 Nëntori", Fier*” me fond limit 44 449 209. 27 (*dyzet e katër milion e katërqind e dyzet e nente mije e dyqind e nente pike njezet e shtate*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

